

VENDIM
Nr. 513, datë 1.8.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË INFORMACIONIT TË
DETAJUAR, QË PËRMBAN RAPORTI PËR ÇDO VEND NË LIDHJE ME GRUPET
E SHOQËRIVE SHUMËKOMBËSHE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 63/4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave dhe i informacionit të detajuar, që përmban raporti për çdo vend në lidhje me grupet e shoqërive shumëkombëshe.

Neni 2
Përkufizime

Kuptimi i termave “entitet përbërës”, “entitet raportues” dhe “pasqyra financiare të konsoliduara”, në kuadër të plotësimit të raportit për çdo vend, janë përcaktuar përkatësisht në shkronjat “ç”, “d” dhe “P”, të nenit 63/1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3
Informacion i përgjithshëm për plotësimin e një raporti për çdo vend

1. Informacioni i përgjithshëm sipas këtij neni i shërben plotësimit të një raporti për çdo vend, në përputhje me nenin 63/4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Të dhënat e selisë së përhershme raportohen duke iu referuar juridiksionit tatimor, në të cilin ajo ndodhet dhe jo duke iu referuar juridiksionit tatimor të rezidencës së njësisë së biznesit, pjesë e së cilës është selia e përhershme. Raportimi i juridiksionit tatimor të rezidencës për njësinë e biznesit, ku bën pjesë selia e përhershme, duhet të përjashtojë të dhënat financiare që lidhen me selinë e përhershme.

3. Të dhënat e raportuara në tabelat përkatëse mbulojnë vitin fiskal të entitetit raportues. Për entitetet përbërëse, në diskrecionin e entitetit raportues, tabelat pasqyrojnë mbi një bazë të qëndrueshme:

- a) informacion për vitin fiskal të entiteteve përbërëse përkatëse, që përfundon në të njëjtën datë me vitin fiskal të entitetit raportues ose që përfundon brenda periudhës 12-mujore, që i paraprin kësaj date; ose
- b) informacion për të gjitha entitetet përbërëse përkatëse të raportuara për vitin fiskal të entitetit raportues.

¹ Ky vendim është përfshirë me direktivën e Këshillit (BE) 2016/881, e datës 25 maj 2016, që ndryshon direktivën 2011/16/BE, lidhur me shkëmbimin automatik të detyrueshëm të informacionit në fushën e tatimeve. Numri CELEX 32016L0881, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 146, datë 3.6.2016, faqe 8–21.

4. Entiteti raportues përdor vazhdimisht të njëjtat burime të dhënash nga viti në vit në plotësimin e tabelës përkatëse. Entiteti raportues mund të zgjedhë të përdorë të dhëna nga paketat e saj raportuese të konsoliduara, nga pasqyrat financiare të njëjësive të veçanta, pasqyrat financiare rregullatore ose llogaritë e menaxhimit të brendshëm. Nuk është e nevojshme të rakordohet raportimi i të ardhurave, i fitimit dhe i tatimit në tabelë me pasqyrat financiare të konsoliduara. Nëse pasqyrat financiare statutores përdoren si bazë për raportim, të gjitha shumat konvertohen në monedhën funksionale të deklaruar të entitetit raportues, me kursin mesatar të këmbimit për vitin e deklaruar në tabelën 3, “Informacion shtesë”, të shtojcës 1. Në këtë tabelë, entiteti raportues jep një përshkrim të shkurtër të burimeve të të dhënave të përdorura në përgatitjen e tabelës përkatëse. Nuk ka nevojë të bëhen rregullime për dallimet në parimet e kontabilitetit të aplikuar nga një juridiksion tatimor në juridiksionin tjetër tatimor. Nëse bëhet një ndryshim në burimin e të dhënave të përdorura nga viti në vit, entiteti raportues shpjegon arsyet e ndryshimit dhe pasojat e tij në tabelën 3, “Informacion shtesë”, të shtojcës 1.

Neni 4

Përmbajtja dhe formati i raportit për çdo vend

1. Në përputhje me nenin 63/4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, raporti për çdo vend përmban informacionin e dhënë në tabelat 1, 2 dhe 3, të shtojcës 1, dhe plotësimi i tyre bëhet në përputhje me përkufizimet dhe udhëzuesin për secilën tabelë.

2. Plotësimi i raportit për çdo vend në Shqipëri bazohet në udhëzuesin e publikuar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik për zbatimin e raportimit për çdo vend, i cili përditësohet kohë pas kohe.

Neni 5

Njoftimet

1. Detyrimi i njoftimit në lidhje me raportimin për çdo vend, referuar nenit 63/3, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zbatohet për të gjitha entitetet përbërëse të një grupi shoqërie shumëkombëshe, që janë rezidente tatimore në Shqipëri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 63/1 të këtij ligji. Pavarësisht nëse vepron si entiteti mëmë përfundimtar ose ndryshe, entiteti informon administratën tatimore për detajet e entitetit raportues, nëpërmjet informacionit specifik që jepet sipas shtojcës 2.

2. Kërkesa për të dorëzuar një formular njoftimi lind në rast të çdo ndryshimi në informacionin e dhënë më parë dhe bëhet brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 6, të këtij vendimi. Nëse nuk ka ndryshime në rrethana ose informacion që nga dorëzimi fillestar i njoftimit në administratën tatimore, një entitet përbërës rezident tatimor i një grupi shoqërie shumëkombëshe është i përjashtuar nga dorëzimi i formularit të njoftimit për periudhat pasuese.

3. Në rastet kur shumë entitete përbërëse të të njëjtë grup shoqërie shumëkombëshe janë rezidente tatimore në Shqipëri, grupi i shoqërive shumëkombëshe mund të caktojë një nga këto entitete për të paraqitur një njoftim të vetëm, që përfshin të gjitha entitetet përbërëse rezidente tatimore në Shqipëri. Në raste të tilla, njoftimi liston në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha entitetet përbërëse rezidente në Shqipëri.

Neni 6

Afati i njoftimit

1. Sipas nenit 63/3, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet një njoftim për të gjitha entitetet përbërëse rezidente tatimore të një grupi shoqërie shumëkombëshe, në kuptim të nenit 63/1 të ligjit, jo më vonë se dita e fundit e

2. Periudha e njoftimit pasqyron periudhën fiskale të entitetit mëmë përfundimtar të grupit të shoqërive shumëkombëshe. Koncepti i vitit fiskal për qëllime raportimi mbetet i pavarur nga fakti nëse entitetet përbërëse individuale brenda grupit të shoqërive shumëkombëshe kanë një vit fiskal të ndryshëm nga viti kalendarik ose nëse ka vite fiskale të ndryshme brenda grupit të shoqërive shumëkombëshe. Kriteri kryesor është viti fiskal i përcaktuar nga detyrimet raportuese të grupit të shoqërive shumëkombëshe dhe entitetit mëmë përfundimtar të tij.

Dorëzimi i një raporti për çdo vend pranë administratës tatimore të Republikës së Shqipërisë

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
PËRMBAJTJA DHE FORMATI I RAPORTIT PËR ÇDO VEND

Emri i grupit të shoqërive shumëkombëshe:
Viti fiskal:
Monedha e përdorur:

[illegible]

UDHËZUES PËR PËRGATTJTJEN E TABELËS 1

Juridiksioni tatimor. Në kolonën e parë të tabelës, entiteti raportues liston të gjitha juridiksionet tatimore, në të cilat entitetet përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe janë rezidente për qëllime tatimore. Juridiksioni tatimor është juridiksioni shtetëror ose joshtetëror, që ka autonomi fiskale. Një rresht i veçantë duhet të përfshihet për të gjitha entitetet përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe, që konsiderohen nga entiteti raportues se nuk janë rezidente në ndonjë juridiksion tatimor për qëllime tatimore. Kur një entitet përbërës është rezident në më shumë se një juridiksion tatimor, zbatohet marrëveshja tatimore përkatëse për të përcaktuar juridiksionin tatimor të rezidencës. Kur nuk ekziston asnjë marrëveshje tatimore e zbatueshme, entiteti përbërës raportohet në juridiksionin tatimor të vendit të menaxhimit efektiv të entitetit përbërës. Vendi i menaxhimit efektiv përcaktohet në përputhje me parashikimet e nenit 4 të modelit të Konventës Tatimore të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe komentarit të tij.

Të ardhurat. Në tri kolonat e tabelës nën titullin “Të ardhurat”, entiteti raportues raporton informacionin në vijim: (i) shumën e të ardhurave të të gjitha entiteteve përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe në juridiksionin tatimor përkatës, të krijuara nga transaksionet me palët e lidhura; (ii) shumën e të ardhurave të të gjitha entiteteve përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe në juridiksionin tatimor përkatës, të krijuara nga transaksionet me palë të pavarura; dhe (iii) totalin e (i) dhe (ii). Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e inventarit dhe pronave, shërbimet, honorarët, interesat, primet dhe çdo shumë tjetër. Të ardhurat përjashtojnë pagesat e marra nga entitetet përbërëse të tjera që trajtohen si dividend në juridiksionin tatimor të pagesit.

Fitimi (humbja) para tatimit mbi të ardhurat. Në kolonën e pestë të tabelës, entiteti raportues raporton shumën e fitimit (humbjes) para tatimit mbi të ardhurat për të gjitha entitetet përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës. Fitimi (humbja) para tatimit mbi të ardhurat përfshin të gjithë zërat e jashtëzakonshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i paguar mbi të ardhurat (në bazë të parave cash). Në kolonën e gjashtë të tabelës, entiteti raportues raporton shumën totale të tatimit të paguar mbi të ardhurat gjatë vitit përkatës fiskal nga të gjitha entitetet përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës. Tatimi i paguar përfshin tatimin e parave *cash* të paguar nga entiteti përbërës në juridiksionin tatimor të rezidencës dhe në të gjitha juridiksionet e tjera tatimore. Tatimi i paguar përfshin tatimin e mbajtur në burim të paguar nga entitetet e tjera (shoqëritë e lidhura dhe shoqëritë e pavarura) në lidhje me pagesat ndaj entitetit përbërës. Kështu, nëse shoqëria A, rezidente në juridiksionin tatimor A, fiton interes në juridiksionin tatimor B, tatimi i mbajtur në juridiksionin tatimor B raportohet nga shoqëria A.

Tatimi i përlllogaritur mbi të ardhurat (viti aktual). Në kolonën e shtatë të tabelës, entiteti raportues raporton shumën aktuale të shpenzimit tatimor të përlllogaritur, të regjistruar mbi fitimet ose humbjet e tatueshme të vitit të raportimit të të gjitha entiteteve përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës. Shpenzimi tatimor aktual pasqyron vetëm veprimet në vitin aktual dhe nuk përfshin tatimet e shtyra ose parashikime për detyrime tatimore jo të sigurta.

Kapitali i deklaruar. Në kolonën e tetë të tabelës, entiteti raportues raporton shumën e kapitalit të deklaruar të të gjitha entiteteve përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës. Për sa u përket selive të përhershme, kapitali i deklaruar raportohet nga entiteti i selisë së

përhershme, përveç rasteve kur ekziston një kërkesë kapitali e përcaktuar, në juridiksionin tatimor të selisë së përhershme për qëllime rregullore.

Fitimet e akumuluar. Në kolonën e nëntë të tabelës, entiteti raportues raporton shumën e të ardhurave totale të akumuluar të të gjitha entiteteve përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës në fund të vitit. Për sa i përket selive të përhershme, fitimet e akumuluar raportohen nga entiteti i selisë së përhershme.

Numri i punonjësve. Në kolonën e dhjetë të tabelës, entiteti raportues raporton numrin total të punonjësve me kohë të plotë të të gjitha entiteteve përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës. Numri i punonjësve mund të raportohet në fund të vitit, në bazë të niveleve mesatare të punësimit për vitin, ose mbi çdo bazë tjetër të aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha juridiksionet tatimore dhe nga viti në vit. Për këtë qëllim, kontraktorët e pavarur që marrin pjesë në aktivitetet e zakonshme operative të entitetit përbërës, mund të raportohen si punonjës. Rrumbullakimi ose përafrimi i arsyeshëm i numrit të punonjësve është i lejueshëm, me kusht që një rrumbullakim ose përafrim i tillë të mos shtrembërojë materialisht shpërndarjen relative të punonjësve nëpër juridiksione të ndryshme tatimore. Qasje e qëndrueshme duhet të zbatohet nga viti në vit dhe në të gjitha entitetet.

Asetet e prekshme përveç parasë cash dhe ekuivalentëve të parasë cash. Në kolonën e njëmbëdhjetë të tabelës, entiteti raportues raporton shumën e vlerave neto kontabël të aseteve materiale të të gjitha entiteteve përbërëse rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin tatimor përkatës. Në lidhje me selitë e përhershme, asetet raportohen duke iu referuar juridiksionit tatimor, në të cilin ndodhet selia e përhershme. Asetet e prekshme për këtë qëllim nuk përfshijnë paratë *cash* ose ekuivalentët e parasë *cash*, asetet jomateriale ose asetet financiare.

Tabela 2. Lista e të gjitha entiteteve përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe të përfshira në secilin grupim sipas juridiksionit tatimor

Emri i grupit të shoqërive shumëkombëshe: Viti fiskal:															
Juridiksioni tatimor	Entitetet përbërëse rezidente në juridiksionin tatimor	Juridiksioni tatimor i organizatës ose i korporatës, nëse është i ndryshëm nga juridiksioni tatimor i rezidencës	Numri i identifikimit tatimor	Veprimtaria (të) kryesore e (të) biznesit											
				Kërkim dhe zhvillim	Mbajtje ose administrim i pronësive intelektuale	Blerje ose prokurime	Fabrikim ose prodhim	Shitje, marketing ose shpërndarje	Shërbime administrative, menaxhimi ose mbështetëse	Ofim i shërbimeve për palë jo të lidhura	Financa të brendshme të grupit	Shërbime financiare të rregulluara	Sigurime	Mbajtje e aksioneve ose e instrumenteve të tjera të kapitalit	Pa veprimtari
	1.														
	2.														
	3.														
	1.														
	2.														
	3.														

1. Ju lutemi, specifikoni natyrën e veprimtarisë së entitetit përbërës në tabelën 3, “Informacion shtesë”.

UDHËZUES PËR PËRGATITJEN E TABELËS 2

Entitetet përbërëse rezidente në juridiksionin tatimor. Entiteti raportues liston, sipas çdo juridiksioni tatimor dhe sipas emrit të entitetit, të gjitha entitetet përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe, që janë rezidente për qëllime tatimore në juridiksionin përkatës tatimor. Siç është shprehur më sipër në lidhje me selitë e përhershme, selia e përhershme duhet të renditet duke iu referuar juridiksionit tatimor në të cilin ndodhet. Duhet të shënohet entiteti, të cilit i përket një seli e përhershme (p.sh. nëse një grup shoqërie shumëkombëshe përfshin një entitet përbërës, “XYZ Corp”, i cili është rezident në juridiksionin tatimor A dhe ka një seli të përhershme në juridiksionin tatimor B, tabela 2 duhet të përfshijë përshkrimin “XYZ Corp” për entitetin përbërës në

juridiksionin tatimor A dhe përshkrimin “XYZ Corp - juridiksioni tatimor A SP” për selinë e përhershme në juridiksionin tatimor B).

Juridiksioni tatimor i organizatës ose i korporatës, nëse është i ndryshëm nga juridiksioni tatimor i rezidencës. Entiteti raportues raporton emrin e juridiksionit tatimor sipas ligjeve të të cilit është organizuar ose inkorporuar entiteti përbërës i grupit të shoqërive shumëkombëshe, nëse ai është i ndryshëm nga juridiksioni tatimor i rezidencës.

Numri i identifikimit tatimor. Entiteti raportues raporton numrin e identifikimit tatimor për të gjitha entitetet përbërëse të grupit të shoqërive shumëkombëshe, siç përcaktohet nga administrata tatimore në juridiksionin tatimor të çdo entiteti përbërës. Kur një entitet përbërës nuk ka një numër të identifikimit tatimor, vendoset vlera “NOTIN”. Kjo fushë nuk duhet të lihet bosh.

Veprimtaria(të) kryesore e (të) biznesit. Entiteti raportues përcakton natyrën e veprimtarisë ose të veprimtarive kryesore të biznesit të kryera nga entiteti përbërës në juridiksionin tatimor përkatës, duke zgjedhur një ose më shumë nga veprimtaritë e përshtatshme të dhëna në listën e mëposhtme. Nëse zgjidhet “tjetër”, entiteti raportues specifikon natyrën e veprimtarisë që ushtrohet nga entiteti përbërës në tabelën përkatëse “Informacion shtesë”.

Mund të zgjidhen më shumë se një veprimtari biznesi për çdo entitet përbërës, sipas rastit.

Veprimtari biznesi
Kërkim dhe zhvillim
Mbajtje ose administrim i pronësisë intelektuale
Blerje ose prokurime
Fabrikim ose prodhim
Shitje, marketing ose shpërndarje
Shërbime administrative, menaxhimi ose mbështetëse
Ofrim i shërbimeve për palë jo të lidhura
Financa të brendshme të grupit
Shërbime financiare të rregulluara
Sigurime
Mbajtje e aksioneve ose e instrumenteve të tjera të kapitalit
Pa veprimtari
Tjetër

Tabela 3. Informacion shtesë

Emri i grupit të shoqërive shumëkombëshe:
<i>Ju lutemi, përfshini çdo informacion ose shpjegim tjetër të shkurtër, që e konsideroni të nevojshëm ose që lehtëson kuptimin e informacionit të detyrueshëm të dhënë në raportin për çdo vend.</i>

UDHËZUES PËR PËRGATITJEN E TABELËS 3

Grupeve të shoqërive shumëkombëshe u kërkohet të japin një përshkrim të burimeve të të dhënave të përdorura për përgatitjen e raportit për çdo vend. Megjithëse përshkrimet mund të jenë të shkurtra, ato duhet të jenë të mjaftueshme për të mundësuar kuptimin e burimit të çdo informacioni në raport. Kur zbatohet një parim i përgjithshëm, ai përshkruhet së bashku me çdo përjashtim që ekziston. Kur informacioni që lidhet me një juridiksion të caktuar merret nga burime të ndryshme të dhënash ose kur burimet e të dhënave të përdorura ndryshojnë me kalimin e kohës, kjo duhet të shpjegohet.

Mund të jepen informacione ose shpjegime të tjera, që ndihmojnë më tej kuptimin e informacionit të detyrueshëm të dhënë në raportin për çdo vend, duke përfshirë supozimet që janë bërë gjatë përpilimit të informacionit dhe rregullat e kontabilitetit të zbatuara.

SHTOJCA 2
DETYRIMI I NJOFTIMIT LIDHUR ME RAPORTIN PËR ÇDO VEND

Emri i grupit:

Emri i entitetit shqiptar që jep këtë njoftim:

Numri i identifikimit tatimor të entitetit:

Data e përfundimit të periudhës kontabël:

- Njoftim në përputhje me shkronjën “a”, të nenit 63/3, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

Ky njoftim po dorëzohet në emër të: (Vendosni PO ose JO brenda kutive, sipas rastit)

- entitetit mëmë përfundimtar?

☐

- entitetit përbërës?

☐

- Njoftim në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 63/3, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (kur entiteti shqiptar nuk është entiteti mëmë përfundimtar):

Emri i entitetit raportues:

Juridiksioni ku dorëzohet:

Numri i identifikimit tatimor të entitetit raportues:

Adresa e plotë e entitetit raportues:

Data e përfundimit të periudhës kontabël të entitetit raportues:

Lista e të gjitha entiteteve përbërëse shqiptare:

Emri:

Numri i identifikimit tatimor:

Adresa: